



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 514/3 Prot

Tiranë, më 15.10.2020

V E N D I M

Nr.123, datë 15.10.2020

Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së informacionit të dërguar nëpërmjet kërkesës së punonjësës së Bashkisë Kolonjë, ****, për parregullsi të pretenduara se janë kryer në procedurën e transferimit të përhershëm të saj, për shkak të ristrukturimit të institucionit**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë prej nëpunësës ******,

Vërejtje:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është paraqitur një kërkesë nga nëpunësja e Bashkisë Kolonjë ******, e regjistruar me nr. 514 prot., datë 08.06.2020, në të cilën janë parashtruar pretendimet e saj për parregullsi të kryera gjatë procedurës së transferimit të përhershëm të saj, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në përmbajtjen e kërkesës së saj, nëpunësja ****** parashtrohet se megjithëse është nëpunëse civile në periudhë, prove në pozicionin “Specialist për Marrëdhëniet me Publikun”, në Bashkinë Kolonjë (emëruar me vendim nr. 611, datë 11.03.2019), nëpërmjet Urdhrit nr. 32 (nr. 1823 prot.) datë 18.05.2020, “Për Transferimin e përhershëm të ******” të njësisë përgjegjëse, është transferuar në mënyrë të parregullt në pozicionin

“Specialist One Stop Shop”, në Bashkinë Kolonjë, duke mos u respektuar kriteret e përcaktuara në dispozitat e neneve 48 – 50, të ligjit nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësit civil”.

Për verifikimin e pretendimeve të mësipërme dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera, Komisioneri filloi procesin e hetimit administrativ dhe nëpërmjet shkresës me nr. 514/1 prot., datë 12.06.2020, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me kërkesën e regjistruar me nr. 514 prot., datë 05.06.2020, paraqitur prej nëpunëses *****”, vuri në dijeni institucionin duke kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Në përgjigje të këtij njoftimi, nga ana e institucionit të Bashkisë Kolonjë, nëpërmjet postës elektronike (“e-mail-in” e datës 14.07.2020), është dërguar sqarimi së bashku me dokumentacionin përkatës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë këtij procesi, ka rezultuar e vërtetuar si më poshtë:

Bashkia Kolonjë, në zbatim të strukturës së re të miratuar me Urdhërin nr. 45, datë 10.02.2020 të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e Strukturës dhe Nivelit të Pagave për administratën dhe ndërrmarjet e varësisë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2020” ka kaluar në proces ristrukturimi. Me këtë rast, bazuar në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikës 17 të Kreut II, të Vendimit nr. 125 datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, me urdhrin nr. 77 (693) datë 02.03.2020, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Kolonjë”, u ngrit Komisioni i Ristrukturimit i cili duhej të shqyrtonte mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese ose të propozojë transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike.

Nisur nga gjithë sa më sipër, Komisioni i Ristrukturimit ka përgatitur propozimin me shkrim për transferimin e nëpunësve civilë të ndryshëm, pozicionet e punës të të cilëve janë prekur nga ristrukturimi. Në përfundim të analizës të rastit objekt shqyrtimi, është konstatuar se pozicioni “Specialist për Marrëdhëniet me Publikun”, në të cilin nëpunësja në fjalë po kryente periudhën e provës, në strukturën e re nuk egziston më dhe për këtë arsye Komisioni i ristrukturimit në relacionin e tij nr. 1798 datë 15.05.2020, ka propozuar transferimin e punonjësës ***** në një pozicion të përshtatshëm me arsimimin e saj.

Duke analizuar formularin e përshkrimit të punës të pozicionit “*Specialist i One Stop Shop*”, në të cilin është propozuar nga Komisioni i Ristrukturimit, rezulton se kemi të bëjmë me një pozicion i cili nuk mund të konsiderohet si pjesë e shërbimit civil, kjo për faktin se për nga natyra e punës ky pozicion ka karakter të shërbimit publik të drejtpërdrejtë, që në kuptim të përkufizimit që i bën pika “*dh*” e nenit 4, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, quhen “*Njësi publike direkte të shërbimit*” dhe funksionojnë në bazë të ligjit nr.13/2016 datë 18.02.2016 “*Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë*”, kështu që nuk përfshihen në fushën e shërbimit civil.

Ky konkluzion nuk del vetëm nga emërtimi i përdorur por edhe nga përmbajtja e funksioneve dhe detyrave që kryejnë këta punonjës. Ata nuk kanë kompetenca ekzekutive dhe nuk ushtrojnë autoritet publik të drejtpërdrejtë, por shërbejnë vetëm si pika kontakti për qytetarët, evidentojnë problemet e parashtruara prej tyre dhe i paraqesin përpara punonjësve përkatës të bashkisë, për ti dhënë zgjidhje secilit prej tyre (*analizuar përshkrimi i pozicionit “Specialist One Stop Shop”, dërguar me “e-mail” nga Bashkia Kolonjë*).

Marrëdhëniet e punësimit të punonjësve të këtyre njësive rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës, pra jemi në kushtet kur regjimi juridik i marrëdhënies së punësimit ndryshon. Në lidhje me sa më sipër njësia e burimeve njerëzore nuk duhej të miratonte transferimin e nëpunëses në fjalë në një pozicion jashtë shërbimit civil, por nëse evidentohet fakti i pamundësisë së sistemimit të saj në një pozicion tjetër të shërbimit civil ku ajo përmbushte kërkesat e veçanta, duhet të vijonte me deklarimin e lirimit nga shërbimi civil, sipas përcaktimit të germës “*a/1*”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Por në rastin konkret, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Kolonjë, në zbatim të pikës 20, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, ka përmbyllur procesin me aktin nr.32 (1823 prot.) datë 18.05.2020, “*Për transferimin e përhershëm të ******”, i cili për argumentet e mësipërme dhe bazuar në pikën d, të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, vlerësohet si një akt i paligjshëm.

Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, bazuar në pikën 18, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, Njësia Përgjegjëse duhet tja kthejë aktet Komisionit të Ristrukturimit dhe të kërkojë prej këtij të fundit, rishqyrtimin e këtij rasti, duke vlerësuar edhe një herë mundësinë e sistemimit të nëpunëses në fjalë në një pozicion të një kategorie të njëjtë me pozicionin e

mëparshëm dhe vetëm në rast pamundësie objektive për sistemim, të veprohet sipas procedurës së parashikuar nga pikat 6, 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke urdhëruar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenet 90, 109/d, 110, 111 e 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkohet nga ana e organit publik, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Kolonjë (*Njësia përgjegjëse*), me një akt të ri me shkrim, të anulojë aktin administrativ nr. 32 (1823 prot.) datë 18.05.2020, “Për transferimin e përhershëm të *****” si një akt i paligjshëm.
2. Njësia Përgjegjëse, të kthjejë për rishqyrtim të pjesshëm propozimin e Komisionit të Ristrukturimit (*relacion nr. 1798 prot., datë 15.05.2020*), në pikën ku trajtohet rasti i punonjësës ***** , duke vepruar sipas vërejtjeve në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të

konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

6. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Kolonjë dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha